



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:222684
Datë: 09.06.2022
Numri i dokumentit: 03116357

K.nr.990/21

Gjykata Themelore Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Kundërvajtës, sipas gjykatësit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit V. Z. nga Gjilani, për shkak të kundërvajtjes nga **neni 231 p.5** të Ligjit 05/L-088 për Rregullimin e Trafikut Rrugor lidhur me nenin 19 të Ligjit nr.06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin për Rregullat e Trafikut Rrugor, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 142 të Ligjit për Kundërvajtje, më datë **09.06.2022** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. Z., nga babai I., i lindur më, në Gjilan rr.”Prishtinës” nr.170, me nr.personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, me gjendje të varfur ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me dt. **15.09.2021**, rreth orës **20:20** min, në rrugën “Nëna Terezë” në Gjilan, i lartëshënuari është ndalur nga Policia, me automjetin e llojit “**AUDI**” me targa të regjistrimit, dhe në vend të ngjarjes është konstatuar se ka vozitur automjetin pa patent shofer.

-me këtë veprim ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni **231 p.5** të Ligjit 05/L-088 për Rregullimin e Trafikut Rrugor lidhur me nenin 19 të Ligjit nr.06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin për Rregullat e Trafikut Rrugor, e për atë shpallet përgjegjës dhe,

D Ë N O H E T

Me dënim GJOBE në shumë prej **200 (dyqind) €**.

Obligohet i pandehuri që dënimin e shqiptuar me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në kuptim të nenit 163 p 4, të LMK-së.

Obligohet i pandehuri që kësaj gjykate ti paguaj shumën prej **5 (pesë) euro**, në emër të paushallit gjyqësor në afatin e njëjti si dënimin me gjobë.

Nga një kopje të aktgjykimit ti dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Stacioni Policor - Gjilan, me kërkesën e vetë **nr.00012912778**, të datës **15.09.2021**, ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedura kundërvajtëse, që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas Ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën e parashtruar dhe konstatoi që e njëjta është e ligjshme si dhe ftoi të pandehurin, që të paraqitet në gjykatë për ta dhënë mbrojtjen e tij, i cili në deklaratën e dhënë në gjykatë e pohoi veprën kundërvajtëse, se vërtetë ditën kritike me datë **15.09.2021** në orën **20:20** min, vërtetë është hasur dhe ndalur nga policia pa patent shofer, pasi që ditën kritike ishte dalur urgjent për ta dërguar nënën e tij për kontrollim mjeksor pasi që e njëjta ishte e sëmurë dhe për tu kthyer në shtëpi dhe për këtë i vie keq, kërkon falje, kërkon ndjesë, është hera e parë që i ka ndodhur një vepim i tillë, hera e parë që ballafaqohet me ligjin, është penduar shumë, premtun se herave tjera nuk do ta përsëritë kësaj veprimi dhe thotë se është pa të ardhura dhe lut gjykatën që mundësisht kësaj here ti mer parasysh këto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendosjes ti shqiptojë një dënim sa më të vogël minimal.

Nga shtjellimi i shkresave në lëndë dhe deklarata e të pandehurit i cili e pohoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, gjyqtari krijoi bindjen se vërtetë i pandehuri është kryesisht i vepres kundërvajtëse që i vihet në barrë, vepër kjo e paraparë dhe e sanksionuar me nenin **231 p.5**, të LRRTRR nr. 05/L-088, dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit mori për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 pika 1 të LMK-së se i njëjti i pandehur jeton me kushte të vështira materiale, student, i pa punë, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisë këtë veprim, është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe nga të gjitha këto të pandehurit i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor konform nenin 35 pika 1 të LMK-së, duke konsideruar që edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që i njëjti në të ardhmen të përmbahet mos të kryej vepra të kësaj natyre.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 59 të Ligjit për kundërvajtje. Me të lartë përmendurin u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE **Më dt.09.06.2022**

Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa

Gjyqtari,
Menderes Behluli

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes këtij Divizioni Kundërvajtës.